

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TRECTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ MODERNO DESIGN” SH.P.K.

Themeluesit qe nenshkruajne me poshte jane si vijon:

Z. GURDAL DOGANGUN, i datelindjes 10.10.1982, i biri i Erdag , lindur ne Kars/Turqi dhe banues ne Gebze/Turqi, Shtetas turk mbajtes i pasaportes me nr. U06578888 dhe nr Personal 56698075332 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Z. OSMAN DEMIR, i datelindjes 15.04.1974, i biri i Kenan, lindur ne Hasankale/Turqi dhe banues ne Gebze/Turqi, Shtetas turk mbajtes i pasaportes nr U20706033, me nr. Personal 48592125122, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhet Ortaket e Shoqerise “MODERNO DESIGN” SH.P.K.

Sot me date **23.07.2019**, bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare”, vendosen te themelojne Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregetare “MODERNO DESIGN” SH.P.K, ka si objekt veprimtarie:

1. Import – Eksport nderkombetar te te gjitha mallrave dhe produkteve industriale. Tregtimi me pakice dhe shumice i te gjitha mallrave dhe lendeve te ndertimit, llojeve te makinerive hidraulike te ndryshme per punime ne ndertim, industri, infrastruktura dhe verpra arti.
2. Shitje me pakice dhe shumice apo importi dhe eksportimi i mjeteve motorrike, makine apo motorra me lende djegese te ndryshme apo me bateri/elektrike. Shitbjerje dhe dhenja me qira e cdo lloj mjeti te levizhem per perdom publik, personal apo shendetosor. Transport kombetar dhe nderkombetar per mallra dhe persona.
3. Tregtimi i cdo lloj produkti industrial, materiale ndertimi, produkte kimike, bojra dhe tretes. Projektim, zbatim dhe ndertim i veprave civile dhe industriale. Ndertim, projektim, zbatim i objekteve per banim, sherbim dhe qellime industriale. Sherbime arkitektonike, inxhinierike, elektrike, hidraulike, mjedisore etj.
4. Restaurim i ndertesave dhe objekteve historike dhe te trashegemise kuturore, ura, objekte kulti etj.
5. Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura me lart.
6. Shoqeria, sic mund te ushtroje punet qe tregohen ne objektin e veprimtarise se saj, brenda dhe jashte vendit, ashtu edhe mund te marre pjese, te perfitoje apo te transferoje nga/te palet e tjera, mund te marre pjese ne kapitalet e personave juridike dhe fizike, te vendit apo te huaj, te krijuar ose qe krijohen me qellim tregtie, industrie, etj., ne lidhje me keto fusha.
7. Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura me lart.
8. Shoqeria, mund te kryeje per permbushjen e qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar, blerje pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, t'i marre ose t'i lesjoje me qera, te marre tenderin e tyre. Mund te vendose pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, t'a hipotekoje kete pasuri ne rregjistrin e pasurive te paluajtshme ne emer te saj.
9. Perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licences, dhe te drejtat e tjera qe jane te ngjashme me keto.

10. Marrja pjese neper ankande dhe tendera, si dhe te beje sherbime qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj. Pregatitja e projekte investuese dhe trajnime fizibilituese, si dhe t'i menaxhoje ato.
11. Shoqeria, sic mund te ushtroje punet qe tregohen ne objektin e veprimtarise se saj, brenda dhe jashte vendit, ashtu edhe mund te marre pjese, te perfitoje apo te transferoje nga/te palet e tjera, mund te marre pjese ne kapitalet e personave juridike dhe fizike, te vendit apo te huaj, te krijuar ose qe krijohen me qellim tregtie, industrie, etj., ne lidhje me keto fusha.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne "**MODERNO DESIGN**" SH.P.K.

Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne:

Njesia administrative 12 Rruga Sotir Caci, Ndertesa Lugano 1, Shkalal 1,Ap 5/33 Tirane / Shqiperi

Shoqeria mund te krijoje qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me perqejjesi te kufizuar. Veprimitaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ORTAKOVE mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qoftë se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne rregjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijoje pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose nermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria perqjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimitarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimitarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregetare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte 100.000 (njeqind mijë) Leke. Ne formen e 2 (Dy) kuotave.

Ortaket e shoqerise jane:

1. GURDAL DOGANGUN, zotëruesh i 1(nje) kuote me vlerë 50.000 leke, që perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
2. OSMAN DEMIR, zotëruesh i 1(nje) kuote me vlerë 50.000 leke, që perfaqeson 50% (pesedhjete perqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Kreu IV PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne diten e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit ne Tirane.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 8

1. Shoqeria do te administrohet nga dy administratore **GURDAL DOGANGUN** dhe **OSMAN DEMIR** te cilet perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per një periudhe 5 (pese) vjecare dhe me te drejte rizgjedhje. Administratoret nuk kane kufizime ne tagra dhe perfaqesohen me firme te vetme me te drejta te plota.
2. Administratoret mund t'i delegojne kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.


Kreu VI DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si divident apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise. Ky Akt shtypet dhe nenshkruehet ne 5 (pese) kopje, te gjitha me te njejtën vlerë ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.


ORTAKET THEMELUES

GURDAL DOGANGUN

Gurdal Dogangun


OSMAN DEMIR

Osman Demir



Gurdal Dogangun
Ahmet Smit